

Njoftim për përqendrim me të cilin Allurity BidCo AB, Suedi do të fitojë kontroll të plotë mbi Infigo IS d.o.o. Samobor, Republika e Kroacisë (lënda nr. 08-81 /2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 208/24), më datë 30.04.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar Njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të plotë nga ana e Allurity BidCo AB me seli të regjistruar në Norrlandsgatan 10, 111 43 Stokholm, Suedi, mbi Infigo IS d.o.o. Samobor me seli të regjistruar në rr. Matijasha Korvina 6, Samobor, Kroaci.

-Aktivitetet afariste të **Allurity BidCo AB** janë drejtpërdrejt ose tërthorazi, posedimi dhe menaxhimi i aksioneve dhe pjesëve në degë dhe kompani të lidhura të cilat janë kryesisht aktive në fushën e konsulencës për IT dhe sipërmarrje, dhe kryerja e aktiviteteve të tjera që janë të përputhshme me të lartpërmendurat dhe me veprimtarinë e vet; posedimi dhe menaxhimi i pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme; ofrimi i shërbimeve për kompani të tjera të lidhura në lidhje me administrimin, menaxhimin, shërbime të tjera juridike dhe marketing.

Grupi Allurity i kompanive të cilat i kontrollojnë Parashtruesi ofron shërbime në fushën e sigurisë kibernetike, kryesisht në kategoritë në vijim: konsulencë, menaxhim të shërbimeve, rishitje të softuerit.

Aktivitetet afariste të Shoqërisë të Synuara **Infigo IS d.o.o. Samobor**, dhe të Firmës bijë të Shoqërisë së Synuar, **INFIGO IS SHPKNJP Shkup** janë nga sfera e teknologjisë së informacionit dhe përfshijnë shërbime konsulente kompjuterike. Aktiviteti i tyre afarist përbëhet nga siguria kibernetike, vlerësimi i sigurisë, ofrimi i zgjidhjeve, konsulencë, zgjidhje softuerike dhe shërbime të menaxhuara të sigurisë; veprimtaria e **INFIGO IS SHPKNJP Shkup** është kryesisht e orientuar në konsulencë për siguri kibernetike.

-Infigo IS d.o.o. Samobor ka prezencë korporative në Maqedoninë e Veriut, dhe atë:

-**INFIGO IS SHPKNJP Shkup** me seli të regjistruar në rr. Milan Mijalković nr.22, Shkup – Kisella Vodë, Kisella Vodë, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe me veprimtari të regjistruar prioritare – shërbime konsulente kompjuterike dhe menaxhim të pajisjeve kompjuterike.

Përveç pjesëve në Shoqërinë e Synuar, Shitësit nuk janë pronarë ose bashkëpronarë të shoqërive afariste të cilat ushtrojnë veprimtari në sektorin e teknologjisë së informacionit.

Parashtruesi, Themeluesi i drejtpërdrejtë dhe kompania mëmë e Parashtruesit, si dhe Grupi Allurity i kompanive nuk kanë shitje të drejtpërdrejta, aktivitete afariste dhe të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Vetëm Shoqëria e Synuar dhe Shoqëria bijë e Shoqërisë së Synuar kanë shitje dhe të ardhura të drejtpërdrejta në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Pjesa më e madhe e të ardhurave të pjesëmarrësve realizohet përmes shitjeve të klientët jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut (me këtë rast, një përqindje e vogël e të ardhurave të Shoqërisë së Synuar dhe të firmës bijë të Shoqërisë së Synuar realizohet në Republikën e Maqedonisë së Veriut).

Transaksioni i propozuar potencialisht mund të ketë të bëjë me tregun e shërbimeve të sigurisë kibernetike dhe sigurisë së informacionit. Megjithatë, tregu relevant i mallrave ndoshta është dukshëm më i gjerë, dhe përfshin disa lloje të ndryshme të shërbimeve IT të segmentuara sipas funksionalitetit, përkatësisht (i) konsulencë; (ii) implementim; (iii) outsourcing të IT-së; (iv) outsourcing të proceseve të biznesit; (v) mbështetje softuerike; dhe (vi) mbështetje harduerike. Nga aspekti gjeografik, pjesëmarrësit vlerësojnë se tregu relevant gjeografik mund të definohet si territori kombëtar i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në çdo rast, nuk është e domosdoshme të përcaktohet saktësisht definicioni i tregut relevant dhe mund të mbetet i hapur.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr.54, Shkup ose në e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

07.05.2025

Shkup